

**UNIVERSITETI "MARIN BARLETI"**



**DHOMA KOMBËTARE E  
PËRMBARUESVE GJYQËSORË**



## **MEMORANDUM BASHKËPUNIMI**

*Ndërmjet*

**Universiteti "Marin Barleti"**

*dhe*

**Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë**

Në kuadër të realizimit të misionit të arsimit të lartë për zhvillimin dhe transmetimin e dijeve përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve nga institucionet e arsimit të lartë;

Duke u mbështetur në autonominë e Universitetit "Marin Barleti" që, ndër të tjera, shprehet në organizimin dhe strukturimin sa më efikas të veprimtarive formuese, si dhe hartimin dhe zhvillimin e pavarur të programeve të studimit dhe të projekteve të kërkimit;

Duke u bazuar në të drejtën e Universitetit "Marin Barleti" për të realizuar marrëveshje të pavarura me subjekte publike ose private, vendase ose të huaja, për trajnime, kualifikime ose për projekte kërkimore;

Duke u bazuar në vullnetin dhe qëllimin e mirë të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë për të bashkëpunuar dhe ndihmuar sistemin arsimor universitar në Shqipëri;

Duke synuar realizimin e qëllimeve të Universitetit "Marin Barleti" lidhur me përmirësimin dhe pasurimin e përmbajtjes së programeve të studimit;

**Universiteti "Marin Barleti" (UMB)**, me qendër në Tiranë, Rruga "Sami Frashëri", Nr.41, këtu dhe më poshtë, në këtë Memorandum, i quajtur "**Universiteti**", i përfaqësuar nga Administratori i Deleguar Adriana Berberi dhe **Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë**, me seli ne Tiranë, Rruga "Reshit Çollaku", Pall. "Aurora Konstruksion", Kt.5, këtu dhe më poshtë, në këtë Memorandum, e quajtur "**Dhoma**", e përfaqësuar nga Kryetari i saj, Zoti Petrit Qarri, bien dakord të nënshkruajnë këtë Memorandum.

## **I. MËNYRA E BASHKËPUNIMIT:**

Palët nënshkruese të këtij Memorandumi Bashkëpunimi kanë për qëllim dhe bien dakord që përgjatë zbatimit të tij:

1. të shkëmbejnë mendime dhe propozime mbi bazën e eksperiencave të ndërsjellta për përmbajtjen dhe përmirësimin e programeve të studimit të të gjitha cikleve si dhe të veprimtarive formuese apo kualifikimeve afatshkurtra;
2. të organizojnë seminare, trajnime dhe lektoriume të përbashkëta lidhur me zbatimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me veprimet përmbauese si dhe në fusha të tjera që vlerësohen me interes të përbashkët;
3. të promovojnë në mënyrë të ndërsjellët veprimtaritë e secilit institucion nëpërmjet faqeve të internetit, botimeve periodike, etj.;
4. të marrin pjesë si partnerë në projekte të cilat përputhen me objektin e aktivitetit dhe për të cilat ato kanë interes;
5. të organizojnë takime për promovimin e arritjeve dhe shërbimeve të ndërsjellta;
6. të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre në nxitje të bashkëpunimit në fusha me interes të përbashkët;

## **II. DETYRIMET E PALËVE**

Për realizimin e qëllimeve të këtij Memorandumi, Palët marrin përsipër sa më poshtë:

**1- Universiteti "Marin Barleti" është i gatshëm t'i ofrojë Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë ekspertizën dhe kontributin e tij duke:**

a) trajtuar me përparësi kërkesat që do të vijnë nga Dhoma për pjesëmarrje të studentëve në veprimtari apo projekte të saj, duke propozuar edhe kandidatura të mundshme studentësh të shkëlqyer;

b) ofruar mundësinë për të vënë në dispozicion të Dhomës mjediset universitare për zhvillimin e seminareve apo konsultave, si në rastet e bashkëpunimit dypalësh, ashtu dhe për veprimtari të tjera që i organizon vetë Dhoma, për sa kohë që ato janë në pajtim me vetë veprimtarinë e Universitetit;

c) mbetur i hapur për shkëmbim përvoja me personalitete të Dhomës si dhe me anëtarë apo bashkëpunëtorë të saj, të cilët do të jenë gjithmonë të mirëpritur në lektoriumet që organizon Universiteti apo dhe në veprimtari të tjera akademike, shkencore dhe kulturore të organizuara prej tij;

ç) ofruar mundësinë e bashkëpunimit për realizimin e botimeve të ndryshme me karakter studimor dhe shkencor në fushën e jurisprudencës dhe veçanërisht të fushës së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

**2- Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë** është e gatshme të bashkëpunojë me **Universitetin "Marin Barleti"**, duke:

a) bashkëpunuar me Universitetin për të shkëmbyer përvojën profesionale të anëtarëve apo bashkëpunëtorëve të Dhomës, me personalitetet shkencore të Universitetit në fusha me interes të përbashkët;

b) rënë dakord për zhvillimin e praktikumeve të studentëve të Universitetit pranë anëtarëve të saj. Praktikumat do të zhvillohen në formë trajnimi, në formë praktike apo si forma bashkëpunimi për punët shkencore të studentëve (detyra mësimore, working papers apo mikroteza);

c) qenë e interesuar që iniciativat e saj me karakter studimor e social të gjejnë mbështetje organizative dhe intelektuale prej strukturave të Universitetit.

### **III. PRONËSIA INTELEKTUALE**

1- Kur si rezultat i bashkëpunimeve të kryera në përputhje me këtë Memorandum realizohen produkte që janë objekt i të drejtës mbi pronësinë intelektuale, ato do të trajtohen sipas legjislacionit në fuqi.

2- Palët marrin përsipër të ruajnë fshehtësinë e të dhënave dhe informacioneve të shkëmbyera në kuadrin e këtij Memorandumi, përveç rasteve kur pala tjetër ka dhënë autorizimin me shkrim.

### **IV. MOSMARRËVESHJET**

1- Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin apo zbatimin e këtij Memorandumi do të zgjidhet me mirëkuptim dhe bashkëpunim mes palëve.



**V. TË TJERA**

1- Ky Memorandum hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të tij dhe është i vlefshëm deri 30 ditë pas njoftimit me shkrim për shfuqizimin e tij nga çdonjëra prej palëve.

2- Ky Memorandum hartohet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje me vlerë të njëjtë, nga të cilat një e mban Dhoma dhe një e mban Universiteti.

3- Ky Memorandum nënshkruhet në Tiranë, sot, më datën 4 Qershor 2013.

*Nr. 404 Prot.*  
*Nr. 125*

**UNIVERSITETI "MARIN BARLETI" DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE  
GJYQËSORË PRIVATË**

I përfaqësuar nga

E përfaqësuar nga

  
**Administratore e Deleguar**  
Znj. Adriana BERBERI

**Kryetari**  
Z. Petrit QARRI

